



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1763/24 Datë: 28/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT dega në Prizren për periudhën tre (3) vjeçare. (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
 - *Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor BSc 180 ECTS (R) me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji UBT dega në Prizren që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji UBT dega në Prizren të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji UBT dega në Prizren brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor BSc 180 ECTS (R)	Mimoza Sylejmani Besa Jagxhiu Petrit Ahmeti

Me qëllim të vlerësimit të programit të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT dega në Prizren me ekipet në përbërje: Philippe Bouillard, Ivana Milicevic dhe Nadia Manzoni.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor BSc 180 ECTS. vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 10.07.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji UBT dega në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

